



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Orfaq/Orsk. 04
Data/Hetm. 12. 01. 2017
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

RREGULLORE
PËR
PËRBËRJEN DHE KOMPETENCAT E KOMITETEVE TJERA

Dhjetor, 2016

Në bazë të nenit 11, nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenit 51, paragrafi 51.2 dhe 51.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr 28/2008), nenit 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenit 34, paragrafi 34.2, nenit 40, paragrafi 40.2 të Statutit të Komunës së Fushë-Kosovës, Nr. 98, të datës 17.08.2012, Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27.12.2016, miratoi:

R R E G U L L O R E N P Ë R PËRBËRJEN DHE KOMPETENCAT E KOMITETEVE TJERA

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është që përmes komiteteve tjera sektoriale të lehtësohet puna e Kuvendit të Komunës, përmes shqyrtimeve të propozimeve, ofrimit të rekomandimeve dhe konkluzioneve profesionale, për zgjidhjen e çështjeve të caktuara nëpër sektorët, që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik lokal, planifikimin urban, shërbimet publike, mjedisin, bujqësinë, arsimin, shëndetësinë, mirëqenien sociale, kulturën, rininë dhe sportin në Komunën e Fushë-Kosovës.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Komitetet tjera janë trupa ndihmëse të Kuvendit të Komunës, roli i tyre është që të lehtësojnë punën e Kuvendit të Komunës në lidhje me procesin e marrjes së vendimeve;
2. Komitetet tjera ndihmojnë punën e Kuvendit të Komunës dhe Komitetet e Përhershme, duke ofruar analiza profesionale, konsultime dhe angazhim për çështjet nga fushat e cekura në nenin 1 të Rregullores;
3. Komitetet tjera veprojnë në harmoni me nevojat e Komunës së Fushë-Kosovës që i përcakton Kuvendi i Komunës, japin opinionin e tyre të karakterit këshillëdhënës;
4. Komitetet tjera sektoriale mbajnë së paku katër takime të rregullta vjetore në çdo tremujor të vitit dhe takime tjera sipas nevojës të caktuara me Planin Vjetor të Punës.

II DISPOZITAT E VEÇANTA

Neni 3

1. Sipas kësaj Rregulloreje caktimi i komiteteve tjera sektoriale është:
 - 1.1 Komiteti për Zhvillim Ekonomik;
 - 1.2 Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër, Shërbime Publike dhe Mbrojtje të Mjedisit;

- 1.3 Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport;
- 1.4 Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
- 1.5 Komiteti për Mbrojtje dhe Shpëtim;
- 1.6 Komiteti për Bujqësi dhe Ujëra;
- 1.7 Komiteti për Ndërmjetësim.

Neni 4

Përbërja e Komiteteve tjera

1. Komiteti për Zhvillim Ekonomik përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve. Katër anëtarë janë nga Kuvendi i Komunës, tre anëtarë duhet të jenë ekspertë të fushës së ekonomisë nga Shoqëria Civile;
2. Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër, Shërbime Publike dhe Mbrojtje të Mjedisit përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve. Katër anëtarë janë nga Kuvendi i Komunës, tre anëtarë duhet të jenë ekspertë të fushës së planifikimit urban dhe mjedisit nga Shoqëria Civile;
3. Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve. Katër anëtarë janë nga Kuvendi i Komunës, tre anëtarë duhet të jenë ekspertë të fushës së arsimit, kulturës dhe sportit nga Shoqëria Civile;
4. Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve. Katër anëtarë janë nga Kuvendi i Komunës, tre anëtarë duhet të jenë ekspertë nga fusha e shëndetësisë dhe çështjeve sociale nga Shoqëria Civile;
5. Komiteti për Mbrojtje dhe Shpëtim përbëhet nga shtatë (7) anëtarë. Katër anëtarë janë nga Kuvendi i Komunës, tre anëtarë duhet të jenë ekspertë të fushës së emergjencave civile;
6. Komiteti për Bujqësi dhe Ujëra përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve. Katër anëtarë janë anëtarë nga Kuvendi i Komunës, tre anëtarë duhet të jenë ekspertë të fushës së agrobiznesit dhe ujërave;
7. Komiteti për Ndërmjetësim përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve. Anëtarët e këtij Komiteti, që ndërmjetëson palët në mosmarrëveshje, duhet të jenë anëtarë të Kuvendit të Komunës.
8. Përbërja e Komiteteve tjera sektoriale, të cekura në nenin 4, nga paragrafi 1 deri në 7, duhet të reflektojnë plotësimin e kriterit gjinor dhe multietnik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Kompetencat e Komitetit për Zhvillim Ekonomik

1. Shqyrton propozime dhe jep rekomandime për hartimin e Strategjisë Komunale për Zhvillim Ekonomik Lokal;
2. Bën analiza dhe jep rekomandime për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në territorin e komunës;
3. Bën analiza profesionale dhe nxit zhvillimin e bizneseve prodhuese dhe shërbyese në territorin e komunës;

4. Përkrah programet e zhvillimit ekonomik lokal të komunës, përfshirë këtu organizimin e panairëve të tregtisë dhe tregjeve, inkurajimin e biznesit, zhvillimin e turizmit, bashkëpunimin me bizneset lokale, apo të përfaqësuara në nivel lokal;
5. Inicimin e programeve dhe projekteve zhvillimore ekonomike për zonat urbane dhe rurale;
6. Shqyrton dhe propozon marrjen e masave për zhvillimin ekonomik dhe të infrastrukturës në zonat industriale;
7. Jep rekomandime për ndërtimin e pjesëve të qytetit dhe fshatrave;
8. Merr pjesë në shqyrtimin e programeve të zhvillimit ekonomik lokal në përgjithësi;
9. Bën analiza të situatës ekonomike lokale, jep rekomandime dhe ndihmon në orientimin e zhvillimit të bizneseve në programet ekonomike të kërkuara në treg;
10. Inkurajon bizneset lokale, që në kuadër të programeve investuese dhe zgjerimit të biznesit të tyre, të punësojnë persona me aftësi të kufizuara;
11. Komiteti për Zhvillim Ekonomik për punën e tij i raporton me shkrim Kuvendit të Komunës.

Neni 6

Kompetencat e Komitetit për Planifikim Urban, Kadastrë, Shërbime Publike dhe Mbrojtje të Mjedisit

1. Shqyrton propozimet dhe ndihmon për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, planeve urbanistike dhe rregulluese, revidimin e tyre dhe punimin e hartave zonale;
2. Shqyrton propozimet e fushës së Planifikimit Urban, Kadastrit, Shërbimeve Publike dhe Mjedisit dhe ndihmon në caktimin e prioriteteve, përgatitjen e strategjive, planeve të veprimit;
3. Shqyrton dhe inicion propozime për sigurimin e informatave të nevojshme lidhur me ndërtimet ilegale dhe rekomandon marrjen e masave për parandalimin e tyre;
4. Shqyrton informatat për zbatimin e rregullave të ndërtimit dhe kontrollin e standardeve të ndërtimit dhe propozon masa për zbatimin dhe kontrollin e tyre;
5. Jep rekomandime që urbanizimi në territorin e komunës së Fushë-Kosovës të jetë i përshtatshëm dhe i pranueshëm me nevojat që kanë personat me aftësi të kufizuara;
6. Shqyrton azhurnimet dhe ndërrimet e paluajtshme në evidencat përkatëse të kadastrave, brenda afateve të përcaktuara ligjore sipas bazave juridike të prezantuara nga kërkuesit;
7. Shqyrton çështjet që kanë të bëjnë me evidentimin dhe mirëmbajtjen e regjistrave të pronave të komunës;
8. Inicion dhe propozon masa për mbrojtjen e ambientit, me qëllim të parandalimit të ndotjes së mjedisit;
9. Shqyrton dhe jep rekomandime për çështjet që kanë të bëjnë me transportin publik për territorin e komunës;
10. Shqyrton propozime dhe jep rekomandime për realizimin e programeve për parqet, fushat rekreative dhe të argëtimit, shëtitoreve publike dhe rregullimin e hapësirave publike në territorin e komunës;
11. Shqyrton dhe jep rekomandime për planet dhe projekte të ndërlidhura me shërbime publike komunale në përgjithësi;
12. Shqyrton programet e ofrimit të shërbimeve të ujit dhe projektet për menaxhimin e ujërave të zeza;

13. Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër, Shërbime Publike dhe Mbrojtje të Mjedisit i raporton me shkrim Kuvendit të Komunës.

Neni 7

Kompetencat e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport

1. Shqyrton dhe jep rekomandime për Projekt-buxhetin për sektorin e arsimit, kulturës, rinisë dhe sportit;
2. Ndhmon Drejtorinë e Arsimit dhe Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në hartimin e Rregulloreve Komunale, në pajtim me ligjet në fuqi për arsimin, kulturën dhe sportin;
3. Jep rekomandime në lidhje me cilësinë e mësimin në institucionet arsimore;
4. Mbështet bashkëpunimin në arsim, kulturë dhe sport në institucionet publike dhe private;
5. Ndhmon në planifikimin dhe vlerësimin e nevojave arsimore, kulturore, rinore dhe sportive për të gjitha komunitetet, përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara;
6. Shqyrton propozimet dhe inicion planet lokale arsimore, kulturore, rinore dhe sportive;
7. Ndhmon bashkëpunimin shkollë-prindër, bashkëpunimin në mes të shkollave dhe komunitetit;
8. Ndhmon në kremtimin e festave shtetërore, lokale dhe ndërkombëtare;
9. Jep rekomandime për hartimin e programeve dhe projekteve të cilat subvencionohen nga komuna dhe propozon mbështetjen e tyre eventuale;
10. Përkujdeset që trashëgimisë kulturore dhe historike të qytetit t'i kushtohet rëndësi e veçantë;
11. Shqyrton dhe jep rekomandime për prioritetet e programeve për investime kapitale komunale në sferën e arsimit, kulturës, të rinisë dhe sportit;
12. Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport për punën e tij i raporton me shkrim Kuvendit të Komunës.

Neni 8

Kompetencat e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

1. Shqyrton dhe jep rekomandime për Projekt-buxhetin për sektorin e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale;
2. Ndhmon Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në hartimin Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, Statutit të Qendrës për Punë Sociale dhe Rregulloreve Komunale dhe akteve tjera normative të brendshme për organizimin e punës në sektorin e shëndetësisë dhe sektorin për mirëqenie sociale, në pajtim me ligjet në fuqi;
3. Shqyrton dhe jep rekomandime për Projekt-planin vjetor të punës, të përgatitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;
4. Shqyrton dhe propozon masa përkatëse për mbështetjen komunale personave në nevojë, invalidët e luftës, viktimat e dhunës familjare, fëmijët jetimë, të pastrehët, personave me aftësi të kufizuara, të rikthyerit, pensionistët, e tjerë;
5. Vlerëson dhe jep rekomandime për propozimet e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për strategjitë dhe planet e strehimit;
6. Shqyrton programet, në raste emergjente për strehim të refugjatëve, planet dhe zgjidhjet emergjente për fluksin e refugjatëve dhe rikthimin në vendet e tyre;

7. Anëtarët e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në cilësinë e vëzhguesit duhet të jenë prezent në ndarjen e subvencioneve;
8. Jep rekomandime për ndarjen dhe përkrahjen e specializimeve në lëmit e nevojshme për kujdesin parësor shëndetësor;
9. Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për punën e tij i raporton me shkrim Kuvendit të Komunës.

Neni 9

Kompetencat e Komitetit për Mbrojtje dhe Shpëtim

1. Shqyrton propozime dhe jep rekomandime për hartimin e planeve për mbrojtje dhe shpëtim;
2. Merr pjesë në shqyrtimin e planeve dhe programeve që ndërlidhen me vetëdijesimin e qytetarëve për reagim në rastet emergjente;
3. Ndhmon në koordinimin e veprimeve operative për reagim efektiv në funksion të realizimit të mbrojtjes dhe shpëtimit në bashkëpunim me komunat fqinje;
4. Ndhmon në vlerësimin e rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera që mund ta përfshijnë territorin e Komunës së Fushë-Kosovës;
5. Ndhmon në punët organizative në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera për strehimin e qytetarëve të rrezikuar;
6. Komiteti për Mbrojtje dhe Shpëtim për punën e tij i raporton Kuvendit të Komunës.

Neni 10

Kompetencat e Komitetit për Bujqësi dhe Ujëra

1. Shqyrton propozimet dhe jep rekomandime për marrjen e masave për zhvillimin e bujqësisë;
2. Jep rekomandime për hartimin e politikave komunale për zhvillimin e bujqësisë dhe degëve të saj;
3. Jep rekomandime për marrjen e masave për ruajtjen e prodhimeve bujqësore;
4. Ndhmon dhe jep këshilla përmes organizatave që merren me përkrahjen e bujqësisë për fermerët e Komunës së Fushë-Kosovës;
5. Jep rekomandime për marrjen e masave për sigurimin dhe mbrojtjen e pyjeve;
6. Jep rekomandime për krijimin sistemit të ujitjes për tokat bujqësore, duke shfrytëzuar rrjedhën e lumenjve dhe përroskave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës;
7. Komiteti për Bujqësi dhe Ujëra për punën e tij i raporton me shkrim Kuvendit të Komunës.

Neni 11

Kompetencat e Komitetit për Ndërmjetësim

1. Ndërmjetëson në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për qytetarët e territorit të Komunës së Fushë-Kosovës;
2. Shqyrton opinionin dhe merr vlerësimin e palëve në mosmarrëveshje dhe jep rekomandime për zgjidhjen e tyre;

3. Rekomandon dhe udhëzon palët në mosmarrëveshje për procedurat dhe rregullat e parapara me legjislacionin në fuqi për zgjedhjen e tyre, nga organet kompetente në nivelin lokal dhe qendror;
4. Bashkëbisedon me palët në mosmarrëveshje dhe ndihmon në evitimin e konflikteve eventuale ndërmjet tyre;
5. Komiteti për Ndërmjetësim për punën e tij i raporton me shkrim Kuvendit të Komunës.

III. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

**Hyrja në fuqi
Neni 12**

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si nga dita e publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Rr-Nr. 04 2017

Datë: 10.01.2017

Kuvendi i Komunës Fushë-Kosovë

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr. Sc. Fadil Krasniqi**

